Në bazë të nenit 20 dhe nenit 25 të Ligjit për shërbimin gjyqësor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 43/14, 98/15, 6/16, 198/18 dhe 248/18) nenit 2 të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes, të realizimit të seleksionimit administrativ, të provimeve, kontrollimit të besueshmërisë së dëshmive dhe intervistës si dhe mënyrën e vlerësimit të tyre dhe numrit maksimal të pikëve nga procedura e seleksionimit varësisht nga kategoritë e vendeve të punës si dhe çështje të tjera në lidhje me procedurën për punësim të nëpunësve gjyqësor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.236/18), Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë, Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe pëlqimit nga Ministria e financave nr. 18-10209/2 të datës 03.12.2021

**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**
**publikon**
**SHPALLJE PUBLIKE NUMËR 2/2021**
**Për punësim të pesë (pesë) nëpunësve gjyqësor për kohë të pacaktuar**

**1. Kategoria B, niveli B4**
**Udhëheqës i njësisë për punë financiare dhe materiale – 1 (një) realizues**

Kushtet për kryerje të punëve:
Të arritura 300 kredi të fituara sipas EKTS -së ose shkallë të kryer VII/1, fakultetin ekonomik dhe së paku 4 vjet përvojë pune në profesion.
Kompetencat e posaçme të punës:
Njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, sipas nenit 2 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbimin gjyqësor (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.198/18).
Rroga neto në para në vlerë: 31.089,00 denarë

**2. Kategoria B, niveli B1**
**Këshilltar i pavarur gjyqësor – 3 (tre) realizues**

Kushtet për kryerje të punëve:
Të arritura 300 kredi të fituara sipas EKTS -së ose shkallë të kryer VII/1, fakultetin juridik, me provim të dhënë të jurisprudencës dhe së paku 6 vjet përvojë pune në profesion, pas provimit të dhënë të jurisprudencës.

- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët e interesuar, obligohen që të parashtrojnë fletëparaqitje të plotësuar për punësim të nëpunësit gjyqësor (formularë të publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 236/18) me dëshmitë për plotësim të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës në të cilin paraqiten në origjinal ose kopje të vërtetuara në Noter:
-Certifikatë për arsimin e kryer përkatës
-Dëshmi për përvojë pune
-Certifikatë të shtetësisë
-Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore
-Certifikatë ose vërtetim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës
-Diplomë, certifikatë ose vërtetim si dëshmi për njohjen e një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht)
-Diplomë, certifikatë ose vërtetim si dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë

Fletëparaqitja, krahas dëshmive, është e obligueshme të përmbajë: emër dhe mbiemër të kandidatit të mbështetura me dëshmi për identifikim personal, vendbanim, gjegjësisht vendqëndrim të kandidatit, e – mail adresë ose telefon për kontakt.

Kompetencat e posaçme të punës:
Njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, sipas nenit 2 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbimin gjyqësor (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.198/18).
Rroga neto në para në vlerë: 40.025,00 denarë

**3. Kategoria B, niveli B1**
**Këshilltar i pavarur gjyqësor në Këshillin e shërbimit gjyqësor – 1 (një) realizues**

Kushtet për kryerje të punëve:
Të arritura 300 kredi të fituara sipas EKTS -së ose shkallë të kryer VII/1, fakultetin juridik, me provim të dhënë të jurisprudencës dhe së paku 6 vjet përvojë pune në profesion, pas provimit të dhënë të jurisprudencës.

Kompetencat e posaçme të punës:
Njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht), njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, sipas nenit 2 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbimin gjyqësor (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.198/18).
Rroga neto në para në vlerë: 40.025,00 denarë

Për të gjitha vendet e punës:
Orari javor i punës është 40 orë (e hënë – e premte);
Orari i punës ditore 8 orë, nga ora 07:30 deri në ora 15:30;

Krahas kushteve të theksuara të posaçme, të parapara me Rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë, dhe Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës, kandidatët për vendin e theksuar të punës duhet t‘i përmbushin edhe kushtet e përgjithshme të parapara

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjes është 20 (njëzet) ditë nga dita e publikimit të shpalljes në gazetat ditore (duke mos llogaritur ditën e vet publikimit).

Kushtet e theksuara në shpalljen, kandidatët duhet t’i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Vërejtje: Kandidati i cili do të parashtrojë të dhëna të rrejshme do të diskualifikohet nga procedura e mëtejshme.

Vërejtje: Koha dhe data e mbajtjes së seleksionimit administrativ, provimi dhe intervista publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (www.vsrm.mk)

Fletëparaqitjet e dorëzuara jo në kohë, jo plotësisht të plotësuara, të pa rregulluara dhe të pa kompletuara, nuk do të shqyrtohen.

Fletëparaqitjen me dëshmitë, kandidatët obligohen që t’i dorëzojnë drejtpërdrejtë në sportelin për pranim të dokumenteve në Gjykatë, gjatë orarit të punës ose përmes adresës postare:

**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**
**Bul. Krste Misirkov nr.8 Shkup**
**(me shenjë për Shpallje publike numër – 2/21)**

Procedura për seleksionim dhe punësim do të realizohet sipas Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike, formën,

përmbajtjen dhe mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes, të realizimit të seleksionimit administrativ, të provimeve, kontrollimit të besueshmërisë së dëshmive dhe intervistës si dhe mënyrën e vlerësimit të tyre dhe numrit maksimal të pikëve nga procedura e seleksionimit varësisht nga kategoritë e vendeve të punës si dhe çështje të tjera në lidhje me procedurën për punësim të nëpunësve gjyqësor (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.236/18).

Kandidatët që do të kalojnë seleksionimin administrativ provimin me shkrim do ta japin në lokalet e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

në nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit për shërbimin gjyqësor:
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës madhore

Baza e pyetjeve për dhënien e provimit me shkrim, literatura e nevojshme, si dhe fletëparaqitja për nëpunësit gjyqësorë është në faqen zyrtare të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (www.vsrm.mk)